



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 292/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.05.2018 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Florida” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-41011-01-18-2018, me objekt: “*Kanalizime kryesore, Punime për mirëmbajtjen e rrugëve*”, me fond limit 15.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. & “Shëndelli” sh.p.k. nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Ankimues:

“Mali” sh.p.k.
Sheshi “Azem Hajdari”, Lagja “Dardania”, Pallati nr.3, Bajram Curri

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tropojë
Sheshi “Azem Hajdari”, Bajram Curri

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.01.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-41011-01-18-2018, me objekt: “Kanalizime kryesore, Punime për mirëmbajtjen e rrugëve”, me fond limit 15.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

II.2. Në datën 14.02.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. “Florida” sh.p.k. | 9.150.715 lekë, kualifikuar |
| 2. BO “Halili 1” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. | 9.997.590 lekë, kualifikuar |
| 3. “Vllaznimi” sh.p.k. | 11.105.324 lekë, skualifikuar |
| 4. “Mali” sh.p.k. | 13.241.264 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 07.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Konkretisht në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

Në Shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" AK ka kërkuar që operatorët pjesëmarrës të përmbushin këto kriteret: 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore per tre vitet e fundit. Vlera e kërkuar nuk duhet të jete me e vogel se 5 500 000 leke pa t v sh;

3.3 Kapaciteti teknik: 4. Per realizimin e kontrates kerkohen mjetet e makinerite si me poshte: Autobot uji 1 cope, Betonjere 500 liter 1 cope, Buldoz S-80/100 KF 2 cope, Borepastruese 3 cope, Krioehedhese 2 cope.

- Per mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi të paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)

- Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontrate" qiraje (ose formë tjetër huaje) si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit të bere me lart. Kontrata e qerasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimit.

5. Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 20 punonjës për periudhën Janar 2017 -Dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar më Siper.

b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të gjithë periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega e Tatimeve ku është i regjistruar biznesi, shoqëruar këto dhe me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP.

6. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten nje inxhinier ndertimi, drejtues teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV; libreze pune dhe të figurojë në listëpagesa (për gjashtë muajt e fundit).

Pretendimet tona rreth vendimit të -abuar të KV 0:

Ne pretendojmë se ne dokumentacionin e dorëzuar nga Shoqeria “Florida” shpk :

1. Drejtuesi teknik i shoqerise ”Florida” shpk, inxhinieri ndertimit L.RR, nuk figuron ne listepagesat e shoqerise per 6 muajt e fundit (mungon ne muajt Korrik-Gusht-Shtator 2017) ne kundërshtim me piken 6 të kapacitetit teknik të D.S.T. si dhe ,

2. Autobetonieria e markes FIORE e paraqitur, eshte mjet me 4 goma aktive qe shenohet ne regjistrat publike, dhe si i tille duhet te shoqerohej me Akt pronësie, Leje Qarkullimi dhe Akt kolaudimi bashkengjitur.

Ne pretendojmë se ne dokumentacionin e dorëzuar nga ashkimi i shoqerive "HALILI 1" dhe "SHENDELLI" shpk ju mungojne nje sere dokumentacioni:

1. Mungon Vertetimi i xhiros vjetore per vitin 2017 per shoqerine "Shendelli" shpk ne kundershtim me Kapacitetin ekonomik financiar pika b. Kjo per arsye sepse deklarimi i vitit financiar duhej te mbyllej brenda muajit Janar 2018, dhe duke qene se procedura ishte ne date 14.02.2018, si i tille duhej te dorezohej.

2. Shoqerise "Shendelli" shpk ju mungojne formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP per Muajin Dhjetor 2017, si dhe liste-pagesat e muajit Dhjetor 2011 jane te pa "bann dhe hum-mun nga organet tatimore, ne kundershtim ne piken 5/b te kapacitetit teknik te D.S.T.

3. Shoqëria "Shendelli" shpk formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP per Muajin Nentor 2017 i ka te pa deklaruar dhe pa mandat pagese nga banka ne kundershtim me piken 5/b te kapacitetit teknik te DST.

4. Shoqeria "Shendelli" shpk ne kontraten e qera Nr. 1019 rep date 28.04.2011 me shoqerine 'JODY COMPANY" shpk ka marre nje Autobot Uji me targe SR 6942 B, per te cilin nuk ka paraqitur asnje dokumentacion tekniko-ligjor.

5. Shoqeria "Shendelli" shpk ne kontraten e qera Nr. 333 rep date 13.02.2018 ka marre nje Autobot Uji me targe AA 312 IF, per te cilin nuk ka paraqitur Aktin e pronesise se mjetit.

6. Eshte hedhur dokumentacioni i plote per Autobotin e ujit me targe AA 387 PA, ne pronesi te shoqerise "JODY COMPANY" shpk per te cilin nuk figuron asnje kontrate qeraje me palet ofertuese.

7. Shoqeria "HALILI" shpk ka paraqitur si nje Autohot Uji me targe AA 616 HI, i cili ne fakt nuk eshte autohot uji por Autobot per transportin e karburantesh me te gjithë dokumentacionin perkates si i tille dhe AKTIV. Si i tille nuk mund te perdoret per Autobot nji.

8. Shoqerin "HALILI 1" shpk ka depozituar nje kontrate qeraje mjetesh date 09.02.2018 me shoqerine nga Republika e Kosoves "Drini COMPANY" shpk kontrate e cila eshte jo konform ligjit, sepse nuk eshte ne perputhje me nenin 4 te VKM Nr.134 datë 07.03.2003 "Për vertetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara ne Republiken e Shqiperise, për përdorim jashte vendit dhe te dokumentave te huaja per perdorim brenda vendit", i cili parashikon se "Dokumentet e autoriteteve te huaja qe do te përdoren brenda vendit, legalizohen ne përfaqësitë e Republikës se Shqipërisë jashte vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara ne Tirane, legalizolten ne Ministrinë e Puneve te Jashtme.

9. Bashkimit te shoqerive te mesiperme ju mungojne 1 Buldozier, 2 cope Borepastruese si dhe 2 cope kripehedhese.

Vendimi i KVO për të kualifikuar kompanitë "FLORIDA" dhe "HALILI 1" bie ndesh me Nenin 46 pika 1, neni 53 pika 3 te Ligjit Nr.9643. datë 20.11.2006 "PËR PROKURIMIN PUBLIK" i ndryshuar, dhe Nenin 66/3 të VKM nr. 914, Datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i Ndryshuar citoj [...]. Për sa më sipër kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga kompanitë "Florida" dhe "Halili 1". Rivlerësimin e ofertave dhe klasifikimin në vend të parë të ofertës së paraqitur nga kompania "Mali" sh.p.k.

II.4. Në datën 13.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 1165/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar ankesën e paraqitur.

II.5. Në datën 16.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat si në autoritetin kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 1165 prot., datë 26.03.2018, të protokolluar me tonën në datën 29.03.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mali” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. & “Shëndelli” sh.p.k. me argumentin se “Shoqeria “Halili 1“ shpk ka depozituar nje kontrate qeraje mjetesh date 09.02.2018 me shoqerine nga Republika e Kosoves “Drini Company” shpk kontrate e cila eshte jo konform ligjit, sepse nuk eshte ne perputhje me nenin 4 te VKM Nr.134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara ne Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashte vendit dhe te dokumentave te huaja per perdorim brenda vendit”, i cili parashikon se “Dokumentet e autoriteteve te huaja qe do te përdoren brenda vendit, legalizohen ne përfaqësitë e Republikës se Shqipërisë jashte vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara ne Tirane, legalizolten ne Ministrinë e Puneve te Jashtme.” Gjithashtu operatori ekonomik ankimues pretendon se “Bashkimit të shoqërive të mësipërme ju mungojnë 1 Buldozier, 2 copë Borëpastruese si dhe 2 copë kripëhedhëse”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 3.3.4 “Kapaciteti Teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Per realizimin e kontrates kerkohen mjetet e makinerite si me poshte:

- | | |
|----------------------|--------|
| - Ekskavator 0,5 m2 | 1 cope |
| - Rrul me vibrim | 2 cope |
| - Rrul me kompresor | 1 cope |
| - Grejder | 1 cope |
| - Autobot uji | 1 cope |
| - Autobitumatriçe | 1 cope |
| - Asfaltoshtruese | 1 cope |
| - Vibrator thellesie | 1 cope |

- Betonjere 500 liter 1 cope
- Fadrome 1 cope
- Sperkates boje 1 cope
- Autovinç 1 cope
- Buldoz S-80/100 KF 2 cope
- Borepastruese 3 cope
- Autovetshkarkuese mbi 5 ton 5 cope
- Kripehedhese 2 cope

- Mjetet dhe makinerite mund te jene ne pronesi ose me qera.

- Per mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi te paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)

- Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje (ose formë tjetër huaje) si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit te bere me lart. Kontrata e qerasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimit.

Operatori ekonomik duhet te deklaroje se keto mjete nuk duhet te jene te angazhuara ne ndonje kontrate tjeter.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. & “Shëndelli” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti “Deklaratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, Nr.334Rep, Nr.128Kol, datë 13.02.2018, sipas së cilës është përcaktuar pjesëmarrja e palëve në grup sipas këtyre raporteve: Shoqëria “Shëndelli” sh.p.k. 62.3 %; Shoqëria “Halili 1” sh.p.k. 37.7 %.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. & “Shëndelli” sh.p.k., në lidhje me mjetin borëpastrues, rezulton se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

[...]

Shoqëria “Halili 1” sh.p.k.

- Deklaratë mbi disponimin e makinerive
- Kontratë qiraje e lidhur në datën 09.02.2018, ndërmjet shoqërisë “Drini Company” sh.p.k. me seli në Prizren në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Halili 1” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit për mjetet:
 1. Mercedes; serial numer ĘDB6521071K200156; viti i prodhimit 1996; target 04-211-FI (shoqëruar me: Leje qarkullimi, Vërtetim mbi rregullsinë teknike të automjetit, Polica Sigurimit, foto)
 2. Iveco; serial numer ĘJMB1VT00C065627; viti i prodhimit 1999, target 04-210-FI (shoqëruar me: Leje qarkullimi, Vërtetim mbi rregullsinë teknike të automjetit, Polica Sigurimit, foto)
 3. Pllug për pastrimin e dëborës Beilhackc Tipi PV 34, serial numer 84/1195 viti I prodhimit 1987 (Shoqëruar me: Dokument Unik Doganor, Foto)
 4. Pllug për pastrimin e dëborës Kahibacher Tipi SS 290 A. serial numer 51-3442 viti I prodhimit 1978 (Shoqëruar me: Dokument Unik Doganor, Foto)

5. *Shpërndarëse e kripës për rrugë-Kupper Èeisser, Tipi: STA-HD, serial numer 10 463 viti i prodhimit 1986 (Shoqëruar me: Dokument Unik Doganor, Foto)*
6. *Shpërndarëse e kripës për rrugë-Kupper Èeisser, Tipi: STA-HD, serial numer 12 144 viti i prodhimit 1990*

Shoqëria “Shëndelli” sh.p.k.

- *Deklaratë mbi disponimin e makinerive*
- *Kontratë qiraje nr. 333 rep. Nr 127 kol., e lidhur në datën 13.02.2018, ndërmjet shoqërisë “Avdolli” sh.p.k. në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Shëndelli” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit për mjetin:*
 1. *Automjeti Borëpastrues, Marka “Mercedes Benz”, targa AA312IF, Nr. Shasie:XXXXXXXXX, ngjyra portokalli (shoqëruar me: Leje qarkullimi, Police Sigurimi, Certifikatë e kontrollit teknik, dy foto).*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.5. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.6. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.*
- ç) *Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënktraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit. [...]*

III.1.7. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”.

Në Kreun VII, pika 2 po këtu, parashikohet: “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.*

Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.8. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.1.9. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar ne SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. & “Shëndelli” sh.p.k. vëren se, lidhur me kërkesë e autoritetit kontraktor për 3 (tre) borëpastrues, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar përkatësisht dokumentacionin si në vijim: Shoqëria “Halili 1”sh.p.k. ka dorëzuar “Kontratë qiraje”, datë 09.02.2018, të lidhur me shoqërinë “Drini Company” sh.p.k., me seli në Kosovë, me afat nga data 09.02.2018 deri në përfundim të projektit objekt prokurimi. KPP konstaton se objekt të kësaj kontrate ndër të tjera janë edhe dy mjete për pastrimin e dëborës. Gjithashtu, konstatohet se shoqëria “Drini Company” ka selinë e saj në shtetin Kosovë dhe kontrata është lidhur pranë një zyre noteriale po në këtë shtet dhe se ky dokument i dorëzuar për këtë procedurë prokurimi nuk është i shoqëruar me vulë apostille. Shoqëria “Shëndelli” sh.p.k., pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për të vërtetuar disponimin e mjeteve të mësipërme ka dorëzuar “Kontratë e qiraje” datë, 13.02.2018 ndërmjet saj dhe shoqërisë “Avdolli” sh.p.k., për 1 (një) mjet borëpastrues.

III.1.11. Operatori ekonomik ankimues “Mali” sh.p.k., në ankesën e tij drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, ndër të tjera pretendon se: “*Shoqëria “HALILI 1“ shpk ka depozituar një kontratë qeraje mjetesh date 09.02.2018 me shoqërinë nga Republika e Kosoves “Drini COMPANY” shpk kontrate e cila eshte jo konform ligjit, sepse nuk eshte ne perputhje me nenin 4*

te VKM Nr.134 datë 07.03.2003 “Për vertetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara ne Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe te dokumentave te huaja per perdorim brenda vendit”, i cili parashikon se “Dokumentet e autoriteteve te huaja qe do te përdoren brenda vendit, legalizohen ne përfaqësitë e Republikës se Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara ne Tirane, legalizolten ne Ministrinë e Puneve te Jashtme.”

III.1.12. Në ligjin Nr. 9060, datë 08.05.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventen për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja” është përcaktuar: Neni 1- Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë. Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare: a) dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretaritë e gjykatave dhe zyrat përmbare; b) dokumentet administrative; c) aktet noteriale; d) vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si edhe vërtetimin zyrtar e noterial të vërtetësisë se firmave.

Neni 2- Çdo Shtet Palë përjashton nga legalizimi dokumentet e lëshuara në territorin e tij mbi të cilat zbatohet kjo Konventë. Në kuptim të kësaj Konvente, legalizimi nënkupton vetëm aktin e formalitetit, me anë të të cilit agjentët diplomatikë ose konsullorë të shtetit, në territorin e të cilit lëshohet dokumenti, vërtetojnë autenticitetin e firmës, cilësinë me të cilën ka vepruar personi që ka firmosur dokumentin dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës dhe pullës që bart.

Neni 3- Me qëllim që të vërtetohet autenticiteti i firmës, cilësia në të cilën ka vepruar personi që firmos dokumentin dhe, nëse është rasti, identiteti i vulës apo pullës që ai bart, formaliteti i vetëm që mund të kërkohet është paraqitja e një çertifikate, të përshkruar ne nenin 4, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit që nxjerr dokumentin.

Neni 4- Çertifikata e përmendur në nenin 3 paragrafi i parë vendoset për se gjati në një qoshe të dokumentit, sipas modelit bashkëngjitur kësaj Konvente. Megjithëse ajo mund të hartohet në gjuhën zyrtare të autoritetit që e lëshon dhe në një gjuhë të dytë, titulli, çertifikata, duhet të jenë në gjuhën frënge "Apostille" (Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga autoritetet kontraktore është e rëndësishme që operatorët ekonomik me dokumentacionin e tyre përveç se të vërtetojnë se disponojnë kapacitetet e nevojshme ligjore, financiare dhe teknike për realizimin e kontratës duhet të paraqesin dokumentacionin administrativo-ligjor që vërteton këto kapacitete në mënyrën dhe formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në të kundërt dokumentacioni i paraqitur jo në formën e kërkuar është i pavlefshëm. Procedura e legalizimit është e detyrueshme për të gjitha dokumentet e lëshuara nga administrata shqiptare që do të përdoren pranë administratave të shteteve të tjera, apo ato të lëshuara nga administrata e një shteti tjetër që do të përdoren pranë administratës shqiptare. Ajo konsiston në njohjen formale nga punonjësit konsullorë, të vulës dhe nënshkrimit të autoritetit që e ka lëshuar dokumentin. Kjo e bën dokumentin njësoj të vlefshëm, nga pikëpamja ligjore edhe jashtë territorit të vendit ku është lëshuar. Shqipëria, sikundër edhe Kosova janë anëtare të Konventës së Hagës “Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja” të 5 tetorit 1961, që do të thotë se dokumentet shqiptare që do të përdoren në vendet anëtare të së njëjtës Konventë, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore. Në bazë të kësaj Konvente,

dokumentet pajisen me një vulë Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dhe më pas mund të përdoren direkt në institucionin përkatës të vendit pritës. Sa më sipër operatori ekonomik “Halili 1” sh.p.k. pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentacionin ligjor të lëshuar në Republikën e Kosovës (konkretisht aktin noterial “Kontratë qiraje” për mjetet, datë 09.02.2018, ndërmjet shoqërisë “Drini Company” sh.p.k. dhe “Halili 1” sh.p.k., lidhur në shtetin Kosovar), akt i cili në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nuk përmban vulë Apostille, çka sjell si pasojë pavlefshmërinë e këtij dokumentacioni për përdorim pranë administratës Shqiptare. Pra sa më sipër argumentuar, kontrata e qerasë për dy mjete borëpastrues e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. dhe “Shëndelli” sh.p.k. është e pavlefshme. Rrjedhimisht, duke qenë se kjo kontratë konsiderohet e pavlefshme, bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit për 3 (tre) borëpastrues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Mali” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. dhe “Shëndelli” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për sa kohë një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues është pranuar dhe gjendja faktike e juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. dhe “Shëndelli” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke plotësuar kështu interesin e ligjshëm të ankimuesit, rrjedhimisht pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mali” sh.p.k për skualifikimin e operatorit ekonomik “Florida” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: *“Drejtuesi teknik i shoqërisë “Florida” shpk, inxhinieri ndertimit z. L.Rr, nuk figuron ne listepagesat e shoqërisë per 6 muajt e fundit (mungon ne muajt Korrik-Gusht-Shtator 2017) ne kundërshtim me piken 6 te kapacitetit teknik te D.S.T”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Shtojcën 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”* pika 3.3.6 *“Kapaciteti Teknik”,* të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë te pakten një inxhinier ndertimi, drejtues teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa (për gjashtë muajt e fundit).”

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar :

- *Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore për periudhën Janar 2017 – Dhjetor 2017.*
- *Licencë NZ.3573/7, datë 29.08.2017, me drejtues teknik: L.Rr; V.S; M.D; J.B; M.K; A.B*
- *Z. L.Rr – Kontratë pune me shoqërinë “Florida” sh.p.k. me detyrë Drejtues Teknik; Diplomë nr. 2135, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Ndërtim; CV; Librezë Pune*
- *Znj. E.L – Kontratë pune me shoqërinë “Florida” sh.p.k. me detyrë Drejtues Teknik; Diplomë nr. 1909, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Ndërtim; CV; Librezë Pune*

- Z. M.K – Kontratë pune me shoqërinë “Florida” sh.p.k. me detyrë Drejtues Teknik; Diplomë nr. B-1779, Fakulteti i Gjeologji Minierave, në Degën e Minierave; CV; Librezë Pune
- Znj. J.D – Kontratë pune me shoqërinë “Florida” sh.p.k. me detyrë Drejtues Teknik; Diplomë nr. 3536, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Mjedis, Titulli Inxhinier Mjedis, CV; Librezë Pune
- Z. J.K – Kontratë pune me shoqërinë “Florida” sh.p.k. me detyrë Drejtues Teknik; Diplomë nr. B-2074, Fakulteti i Gjeologji Minierave, në Degën e Minierave; CV; Librezë Pune
- Z.A.B – Kontratë pune me shoqërinë “Florida” sh.p.k. me detyrë Drejtues Teknik; Diplomë në degën Inxhinieri Miniera; CV; Librezë Pune

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.3.4. Në nenin 26 pika 8 “Kontrata për Punë Publikë” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet si më poshtë: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.3.5. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Florida” sh.p.k. në sistemin e prokurimit elektronik, vëren se ky i fundit në përmbushje të kriterit, ka dorëzuar Licencë profesionale NZ.3573/7, datë 29.08.2017, ku pasqyrohen edhe drejtuesit teknik të shoqërisë, konkretisht: z. L.Rr; z. V.S; z. M.D; z. J.B; z. M.K; z. A.B. Referuar dokumentave të tenderit të publikuara nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka kërkuar që drejtuesi

teknik i punësuar, të jetë inxhinier ndërtimi, vërtetuar kjo me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë pune, dhe të figurojë në listëpagesa për gjashtë muajt e fundit. KPP pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Florida” sh.p.k., konstaton se ndër drejtuesit teknik të deklaruar në licencën profesionale të përmendur më lart, i cili plotëson kërkesën që të jetë inxhinier ndërtimi është vetëm z. L.Rr, por nga verifikimi i listëpagesave të shoqërisë konstatohet se drejtuesi teknik z. L.Rr nuk figuron në listëpagesa për muajt Korrik, Gusht dhe Shtator. Për sa i përket drejtuesve të tjerë teknik të deklaruar në Licencën e sipërpërmendur, asnjë prej tyre nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor që duhet të jenë inxhinierë ndërtimi. Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik “Florida” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor, që drejtuesi teknik duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Mali” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Florida” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për sa kohë një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues është pranuar dhe gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Florida” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke plotësuar kështu interesin e ligjshëm të ankimuesit, rrjedhimisht pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mali” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-41011-01-18-2018, me objekt: “Kanalizime kryesore, Punime për mirëmbajtjen e rrugëve”, me fond limit 15.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Florida” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Halili 1” sh.p.k. dhe “Shëndelli” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mali” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 516 Protokolli

Datë 16.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

